



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 97/2 Prot

Tiranë, më 13.02.2023

V E N D I M

Nr. 14, datë 13.02.2023

Mbi paralajmërimin e institucionit të Avokatit të Popullit për të rregulluar ligjshmërinë në drejtim të aplikimit të institutit të pezullimit nga shërbimi civil.

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 97, datë 30.01.2023, dërguar nga punonjësja ***** Komisioneri është njohur me pretendimin e saj për pengesë të pa motivuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, ku ajo ka qenë e punësuar para pezullimit nga shërbimi civil, për rikthimin në detyrë pas përfundimit të shkakut të pezullimit. Po kështu, bazuar në pretendimin më sipër, punonjësja e konsideron nisjen e procesit të plotësimit të pozicionit të punës si të parregullt, pasi para shpalljes së tij, ajo ka kërkuar rikthimin në pozicionin e punës “Specialist” në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian”, për shkak të parashikimit në një ligj specifik e, për pasojë pozicioni nuk ka qenë efektivisht i lirë.

Duke qenë se në momentin e marrjes dijeni për këtë fakt, Komisioneri është duke mbikëqyruar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil pranë institucionit të Avokatit të Popullit, (proces i nisur me vendimin nr. 141, datë 22.12.2022), për sqarimin e këtij rasti, grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri, për të kryer mbikëqyrjen në subjekt, kërkoi nga njësia përgjegjëse dhe administroi dokumentacionin plotësues, nëpërmjet proces verbalit administrativ të datës 02.02.2023, duke kërkuar që njësia përgjegjëse të mos vijonte më tej me procedurat e

rekrutimit, deri sa të shprehej Komisioneri për këtë çështje, me qëllim që të parandalohet zbatimi i gabuar i ligjit.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar për rastin në fjalë, rezulton se punonjësja ***** është pranuar në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së konkurrimit dhe me aktin nr. 147 prot., datë 10.7.2015, është emëruar në pozicionin e punës "Specialist" në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, në institucionin e Avokatit të Popullit. Aktualisht ky pozicion emërtohet "Specialist" në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian dhe konstatohet se nuk ka asnjë ndryshim në përshkrimin e punës e po kështu edhe në kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme të këtij pozicioni.

Me kërkesën e saj, bazuar në pikën "b", të nenit 53, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; pikën 10/c dhe 12/c, të Kreut I, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil", punonjësja ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil për një afat 2 vjeçar, me motivacionin "për shkak të përzgjedhjes në një strukturë të administratës publike që nuk është pjesë e fushës së veprimit të legjisllacionit të nëpunësit civil" (pasi vetë ligji nr. 12/2018, që rregullon funksionimin e organeve të "vetingut" të policisë, lidhet me afatin 2 vjeçar), ç'ka është miratuar me shkresën nr. 70 prot., datë 28.02.2019, nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit, me lëndë: "Pezullimin nga shërbimi civil për një periudhë 2-vjeçare, të nëpunëses *****".

Kërkesa është e argumentuar me faktin e aplikimit të punonjësës për të marrë pjesë në përbërje të organeve të vlerësimit kalimtar të punonjësve të policisë, në zbatim të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", i ndryshuar.

Konstatohet se punonjësja ka aplikuar në dy procedura të ndryshme të pranimit në organet e reja, si anëtare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe si anëtare e Sekretariatit Teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Pas realizimit të procedurave të pranimit, të cilat janë specifike vetëm për këtë ligj, rezulton se ajo është shpallur fituese nga Bordi Përzgjedhës për të dyja pozicionet për të cilat ka aplikuar, si anëtare zëvendësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, si edhe anëtare e Sekretariatit Teknik të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (shih shpalljen e datës e postuar në datën 11.02.2019, të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme "Për zgjidhen anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik për "vetingun" në polici, Gardë e SHÇBA"). Për shkak të ligjit, anëtar i Bordit Përzgjedhës ka qenë edhe Sekretari i Përgjithshëm i Avokatit të Popullit.

Duke qenë se Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ishte i plotësuar në momentin e fillimit të veprimtarisë, punonjësja është emëruar me kohë të plotë si "Anëtare e Sekretariatit Teknik" pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit e, njëkohësisht ka vijuar regjistrimi i saj në listën plotësuese të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Në momentin që është liruar një pozicion pune pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, me aktin e emërimit nr. 112/2, datë 01.11.2019 *“Për fillimin e marrëdhënieve të punës të një anëtarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pas procedurave të zëvendësimit me anëtarin pasues të listës plotësuese”* (pra brenda afatit 2 vjeçar të pezullimit) punonjësja ka kaluar në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, një pozicion me mandat, i lidhur me kohën e ushtrimit të kësaj detyre, të cilën e ka ushtruar deri në datën 31.12.2022, afat kur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 78/2022 (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, dt 13.12.2022), përfundoi veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Me përfundimin e veprimtarisë së këtij organi, Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, me shkresën nr. 136 prot., datë 16.12.2022 *“Për zbatimin e dispozitës së ligjit nr. 12/2018”*, drejtuar Avokatit të Popullit, kërkon nga ky i fundit kthimin në detyrë të punonjësës *****, duke parashtruar të drejtën ligjore për kthimin në vendin e mëparshëm të punës të anëtarëve të Komisionit, mbështetur në nenin 29, pika 3, ligjit nr. 12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, të ndryshuar.

Nga ana tjetër, edhe nëpunësja, nëpërmjet e-mail-it, ka kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit kthimin në detyrë në pozicionin që ajo ushtronte përpara fillimit të periudhës së pezullimit, *“Specialist”* në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë. Në përgjigje të kërkesës së saj, me shkresën nr. 695/1 prot., datë 10.01.2023 *“Kthim përgjigje”*, Sekretari i Përgjithshëm e ka konsideruar të pamundur rikthimin në detyrë të nëpunësës, pasi pezullimi i nëpunësës është bërë mbështetur në pikën “b”, të nenit 53, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, për një periudhë 2–vjeçare dhe që s’mund të jetë më tepër se kaq.

Për më tepër, në shkresën e sipërpërmendur, parashtrohet se Avokati i Popullit nuk është njoftuar mbi ndryshimin e pozicionit të punës dhe statusit, në momentin që nëpunësja në fjalë ka marrë mandatin si *“Anëtare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”*, në mënyrë që në këtë moment, të bëheshin ndryshimet përkatëse në aktin e pezullimit nga shërbimi civil.

Menjëherë pas kësaj përgjigjeje, në datën 19.01.2023, punonjësja është njohur me publikimin në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, të shpalljes së konkurrimit për plotësimin e pozicionit të lirë *“Specialist”* në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë (aktualisht Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian), në institucionin e Avokatit të Popullit, pozicion të cilin ajo e mbante në momentin e pezullimit të statusit të nëpunësit civil.

Për këtë arsye, me shkresën datë 30.01.2023, ajo i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke kërkuar rregullimin e ligjshmërisë, pezullimin e procedurës së konkurrimit dhe kthimin e saj në detyrë.

Nga parashtrimi i rrethanave të mësipërme, të ndikuara nga ndërlidhja e disa dispozitave ligjore e nënligjore specifike për këtë rast, si dhe veprimesh të ndryshme administrative gjatë

periudhës së pezullimit, lind nevoja e një analize të plotë dhe të kujdesshme, në përfundim të cilës konstatohet sa më poshtë:

1. Nëpunësja ******, është pranuar në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së konkurrimit në përfundim të së cilës, me aktin nr. 147 prot., datë **10.7.2015**, është emëruar në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë (*aktualisht Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian*), në institucionin e Avokatit të Popullit.

2. Me miratimin e ligjit nr. 12/2018 “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, nisi procesi i “*vetingut*”, një proces i një rëndësie të veçantë në drejtim të zbatimit të reformave në fushën e drejtësisë dhe organeve ligj zbatuese të rendit publik, që u shoqërua me ngritjen e organeve përkatëse, ndër të cilët edhe Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, i përbërë nga 15 anëtarë të përzgjedhur sipas një procedure të përcaktuar shprehimisht në këtë ligj, me konkurrim të hapur. Konstatohet se nëpunësja ****** ka treguar interes për këtë proces duke aplikuar në përbërje të këtyre organeve. Për rrjedhojë, ajo është përzgjedhur si “*Anëtare zëvendësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit*” dhe si “*Anëtare e Sekretariatit Teknik*” dhe në këto kushte, mbi bazën e kërkesës së saj, me aktin nr. 70, datë 28.02.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Avokatit të Popullit, ajo është pezulluar nga shërbimi civil për një periudhë 2-vjeçare, nisur nga mandati prej 24 muaj, i parashikuar në këtë ligj, për veprimtarinë e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Në vijim të kësaj analize, për shkak të krijimit të vakancës, me aktin nr. 112/2, datë 01.11.2019 “*Për fillimin e marrëdhënies së punës të një anëtari të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit pas procedurave të zëvendësimit me anëtarin pasues të listës plotësuese*”, nëpunësja ****** është ngarkuar me detyrën e “*Anëtarit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit*”, që është pozicion me mandat dhe për të cilin dispozita e nenit 29, pika 3, e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*Në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kthehen në vendet e tyre të punës ose, me pëlqimin e tyre, në vende të barasvlershme*”.

Ndërkohë, ligji nr. 12/2018 ka pësuar disa ndryshime dhe amendime, një prej të cilave është zgjatja e afatit 2-vjeçar të Komisionit, duke e lidhur këtë mandat me përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar për të gjitha subjektet dhe së fundmi, me ndryshimin e miratuar me ligjin nr. 78/2022, afati i veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit u caktua data **31.12.2022**.

3. Me marrjen dijeni të këtij afati përfundimtar (*pas botimit në fletoren zyrtare në datën 13.12.2022*), nëpunësja ******, me anë të e-mail-it të datës 16.12.2022, ka njoftuar institucionin e Avokatit të Popullit duke kërkuar njëkohësisht kthimin në detyrën që ajo ushtronte në atë institucion përpara pezullimit nga shërbimit civil. Me shkresën nr. 695/1, dt.10.01.2023, “*Kthim përgjigje*” të Sekretarit të përgjithshëm të Avokatit të Popullit,

rezulton se kërkesa e nëpunëses, nuk është pranuar nga ana e institucionit me argumentin se, ligjërisht jemi përpara kushteve të procedurës së pezullimit nga shërbimi civil me kërkesë të nëpunësit për një periudhë 2-vjeçare, në zbatim të pikës “b”, të nenit 53 dhe nenit 55, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”. Ky pezullim lidhet me emërimin e saj si “Anëtare e Sekretariatit Teknik” dhe ishte për një afat deri në 2 vjet. Ndërsa lidhur me marrjen e mandatit në pozicionin “Anëtare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”, institucioni nuk është njoftuar zyrtarisht, në mënyrë që ky veprim të shoqërohej me ndryshimin e aktit të pezullimit, apo nxjerrjen e një akti të ri me kushtet e reja të pezullimit, në këtë rast për procedurën e pezullimit për shkak të ligjit.

Ky qëndrim i mbajtur në këtë rast, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Avokatit të Popullit, rëndon padrejtësisht pozitën e nëpunësit duke anashkaluar detyrimet e njësisë përgjegjëse të institucionit në këtë rast. *Së pari*, Sekretari i Përgjithshëm i Avokatit të Popullit ka qenë në dijeni të faktit se punonjësja është përzgjedhur si anëtare zëvendësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e për pasojë është pjesë e listës së tyre, ç’ka do të thotë se në çdo moment ajo mund të kryente këtë detyrë, nëse krijoheshin kushtet. *Së dyti*, edhe pse në momentin që po analizojmë nuk ndodhemi në kushtet e një pezullimi me kërkesë, pasi punonjësja gëzon një mandat të veçantë, por edhe nëse do të ndodheshim në kushtet e pikës “b”, të nenit 53, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kur institucioni ka miratuar një pezullim për një periudhë 2 vjeçare, me kalimin e periudhës së pezullimit parashikohen një sërë veprimesh administrative verifikuese dhe afatesh për njësinë përgjegjëse, të cilat në këtë rast nuk janë respektuar:

Konkretisht, në vendimin nr. 124, datë 17.12.2018 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, në kreun II “Përfundimi i periudhës së pezullimit”, pika 16/1 parashikohet se, “...njësia përgjegjëse, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit të pezullimit, merr masa për të kërkuar nga nëpunësi shprehjen e tij me shkrim lidhur me vijimësinë e marrëdhënies në shërbimin civil” dhe më tej, në pikën 17, përcaktohet se, “Njësia përgjegjëse brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit vendos: a) rikthimin e nëpunësit civil në pozicionin e mëparshëm të punës, nëse ky pozicion është vakant, duke nxjerrë edhe aktin e rikthimit...etj.”.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, me gjithë kalimin e afatit të pezullimit të përcaktuar në aktin nr. 70, dt. 28.02.2019, nuk rezulton që nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të jetë kryer ndonjë veprim për vijimësinë e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësën *****, apo për plotësimin e pozicionit të lënë vakant. Nëse do të ishte komunikuar me punonjësën, do të ritheksohej edhe njëherë specifika e pozicionit të saj të punës dhe do të rregulloheshin aktet, duke e cilësuar rastin si një pezullim për shkak të ligjit. Nga ana tjetër, detyra që ishte caktuar të kryente nëpunësja ***** gjatë pezullimit, ishte funksion publik, i ngarkuar me ligj dhe i publikuar rregullisht në Fletoren Zyrtare (rregullimi i veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit), ç’ka prezumon marrjen dijeni për çështjen dhe mundëson njohjen e gjithkujt që kishte interes apo detyrim për kryerjen e detyrave përkatëse, në një rast të tillë.

Për këtë rast, nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se, nëpunësja në fjalë zotëron ende statusin e nëpunëses së “pezulluar nga shërbimi civil”, dhe ndaj saj nuk ka asnjë vendim apo akt tjetër administrativ, sipas të cilit të ketë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, për ndonjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 63 - 65, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Në të njëjtën linjë me ligjin specifik për vlerësimin kalimtar të punonjësve të policisë, është edhe përcaktimi në nenin 56 “Efektet e pezullimit” të ligjit për nëpunësin civil, sipas të cilit: “1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori”.

Rezulton se, deri në momentin kur, nëpunësja në fjalë dhe Kryetari i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, me shkresën nr. 136 Prot., datë 16.12.2022 “Për zbatimin e dispozitës së ligjit nr. 12/2018”, drejtuar Avokatit të Popullit, ka bërë kërkesë për kthim në detyrën që ajo kryente përpara pezullimit, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e marrëdhënieve me jashtë”, ky pozicion pune për gjithë periudhën, ka qenë i lirë dhe në të gjithë kohën e vakancës nuk është bërë asnjë përpjekje për plotësimin e tij.

Vetëm disa ditë më pas (në dt. 19.01.2023), në një kohë që ishin të gjitha kushtet për kthimin e nëpunëses në fjalë në pozicionin e mëparshëm, ky pozicion pune është shpallur për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit.

Ky veprim i institucionit të Avokatit të Popullit, vlerësohet si një veprim i nxituar që pengon zbatimin e ligjit dhe rëndon pozitën e punonjësës, duke cenuar të drejtat e nëpunësit civil. Do të ishte normale nëse, për nevoja të punës, pozicioni në fjalë do të ishte plotësuar menjëherë pas krijimit të pozicionit të lirë, apo pas kalimit të afatit 3-mujor, apo më tej. Fillimi i veprimeve administrative për plotësimin e pozicionit vetëm disa ditë pas paraqitjes së kërkesës për kthimin e nëpunëses ***** në detyrën e mëparshme, të jep arsye për të arritur në përfundimet e mësipërme.

Nga ana tjetër, jemi para një akt-pezullimi me kërkesë të nëpunësit, me afat 2-vjeçar, të miratuar nga institucioni, por ndërkohë, brenda këtij afati punonjësja ka kaluar në një detyrë tjetër, me mandat të fituar ligjërisht, njëkohësisht me lidhjen e marrëdhënies fillestare të punës me institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, që është “Anëtare zëvendësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”, marrëdhënia e të cilit rregullohet në mënyrë të posaçme, e shprehur në dispozitë të veçantë të ligjit, që është neni 29, pika 3, sipas të cilit, në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kthehen në vendet e tyre të punës, ashtu si e cituam edhe më sipër.

Në këto rrethana, nuk ndodhemi më në kushtet e pezullimit me kërkesë, por jemi në kushtet e pezullimit për shkak të ligjit, veprim juridik, i cili në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar rregullohet në nenin 54, germa “ë”. Në këto rrethana, sipas pikës 3, germa

“a”, të nenit 54, konstatimi i pezullimit bëhet me marrjen dijëni për shkakun e pezullimit nga njësia përgjegjëse e institucionit. Në të njëjtën linjë qëndron edhe përcaktimi në Vendimin e KM nr. 124, datë 17.12.2018 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, në kreun 1 “Pezullimi”.

Për sa i përket pretendimit të institucionit të Avokatit të Popullit, se nuk është njoftuar “zyrtarisht” nga nëpunësja për zgjatjen e afatit të pezullimit, ai nuk qëndron. Kjo për faktin se, së pari një nga anëtarët e Bordit Përzgjedhës ka qenë Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, i cili ka dijëni për faktin dhe së dyti, emërimet dhe mandatet në organe të kësaj natyre, bashkë me ndryshimet ligjore, janë publike dhe të pasqyruara gjithmonë në faqet zyrtare të institucioneve në internet dhe njëkohësisht në Fletoren Zyrtare.

Në rastin konkret, duhet pasur parasysh detyrimi i përcaktuar në dispozitën e nenit 29, të ligjit specifik nr. 12/2018, dhe nenit 56 “Efektet e pezullimit”, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në të cilat parashikohet shprehimisht që, në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit (përveçse në rastet që vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil), nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rastin konkret nuk vërtetohet as fakti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunëses ***** dhe as zënia në mënyrë të përhershme e pozicionit të punës, gjë që do të thotë se nuk ka asnjë pengesë ligjore që punonjësja në fjalë të emërohet në pozicionin që ajo mbante para pezullimit.

Nga gjithë sa u thanë më sipër, njësia përgjegjëse të mbajë parasysh orientimet e Komisionerit, sa i përket aplikimit të institutit të pezullimit nga shërbimi civil, me qëllim që të shmangët zbatimi i gabuar i ligjit dhe të respektohen të drejtat e nëpunësit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të paralajmërohet institucioni për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, duke kryer detyrat si më poshtë:

- Njësia përgjegjëse të ndërpresë menjëherë procedurën e rekrutimit për pozicionin e punës “Specialist” në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian” në institucionin e Avokatit të Popullit.

- Akti për ndërprerjen e procedurës të publikohet në faqen zyrtare të institucionit, me qëllim që të njihen palët me të.
 - Njësia Përgjegjëse të konstatojë zhdukjen e shkakut të pezullimit dhe të rikthejë në pozicionin e mëparshëm të punës, “*Specialiste në Sektorin e marrëdhënieve me jashtë*” nëpunësen *****, pozicion të cilin ajo e mbante përpara momentit të pezullimit, që në strukturën aktuale të institucionit emërtohet “*Specialist në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian*”.
2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **10 ditë** nga marrja dijëni e vendimit dhe pas kalimit të këtij afati të informohet me shkrim Komisioneri për masat e marra duke dërguar edhe aktet administrative që kanë dalë për rregullimin e situatës ligjore.
3. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Avokatit të Popullit dhe punonjësja *****.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha